

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**

Vorsteher

Alex Hürzeler
Regierungsrat
Bachstrasse 15, 5001 Aarau
Telefon zentral 062 835 20 00
Fax 062 835 20 06
alex.huerzeler@ag.ch
www.ag.ch/bks

Drejtuar prindërve të
nxënësve dhe nxënësve të shkollës
fillore nga Aargau

1 Tetor 2021

Testet e përsëritura Covid-19 në shkolla

Të nderuar prindër

Këshilli i qeverisjes i Aargau ka vendosur në fillim të prillit, që edhe në shkolla të kryhet një testim i gjerë. Këshilli i qeverisjes i Aargau është i bindur që testimi i përsëritur jep një kontribut të rëndësishëm për luftën kundër pandemisë.

Shkolla e fëmijës tuaj është regjistruar për testimin javor të përsëritur. Pjesëmarrja në teste për fëmijën tuaj është me bazë vullnetare dhe falas.

Testet janë mostra të pështymës. Ato merren në mëngjes në shtëpi. Mostra e pështymës nuk është as e pakëndshme dhe as nuk shkakton dhimbje. Fëmija juaj e sjell kampionin në shkollë. Më pas ai do të përzihet dhe testohet në mënyrë anonime në një laborator me kampione të tjera nga klasa.

Nëse një kampion i tillë i përzier testohet pozitiv, të gjithë personat pjesëmarrës të kësaj klase do të testohen edhe njëherë një e nga një në shkollë. Mbi rezultatet pozitive të testimit në rastin e një kampioni të përzier ose mbi një kampion individual ju do të informoheni ju vetë dje shkolla e fëmijës tuaj. Personat e testuar pozitivisht futen menjëherë në izolim dhe përkujdesja ndaj tyre kryhet nga Contact Tracing (CONTI).

Për testet vullnetare duhet që çdo person të regjistrohet online një herë. Linkun e regjistrimit e merrni direkt nga shkolla e fëmijës tuaj. Me këtë regjistrim ju jepni në mënyrë eksplicite edhe **miratimin tuaj personal** për testet e përsëritura dhe përpunimin e të dhënave që nevojitet për një gjë të tillë.

Në rast se keni pyetje mbi testimin e përsëritur, shkolla juaj është me kënaqësi në dispozicionin tuaj. Informacione të tjera gjeni gjithashtu në www.ag.ch/coronavirus-rete.

Ne jemi të bindur që me këtë masë do ta kufizojmë pandeminë dhe do ti mbrojmë pjesëtarët e shkollës dhe familjet e tyre në mënyrë optimale.

Faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj. Ne nuk e ulim ritmin tani!

Sinqerisht



Alex Hürzeler

Këshilltar i qeverisjes